REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:155900

Datë: 23.02.2024

Numri i dokumentit: 05368304

C.nr.2409/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Edije Sezairi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L.H. nga Prizreni, cilin me autorizim e përfaqëson avokat A.Th. nga Prizreni, kundër të paditurës P.K. – Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, me objekt të kontestit shpërblimi i pagës së trembëdhjetë, me vlerë të kontestit 721.14 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 21.02.2024, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I. **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit L.H. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të "*DETYROHET e paditura P.K. - Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, që paditësit në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitin 2022, t'ia paguaj shumën prej 721.14 euro, me kamat ligjore prej 8 % nga dita e arritjes së kërkesës e deri në pagesën përfundimtare*" **e pa bazuar.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij avokat A.Th. në këtë gjykatë ka paraqitur padi, kundër të paditurës P.K. - Drejtoria e Përgjithshme me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar se të e paditura është në marrëdhënie pune, dhe në bazë të rregullativës ligjore në fuqi, përkatësisht Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, të njëjtit i takon shpërblimi i një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt në fund të vitit bazuar në vlerësimet e përformancës së punës, pagave jubilare dhe shujtave ditore.
Nga arsyet e paraqitura në padi, baza ligjore e theksuar, kanë kërkuar nga gjykata që të obligoj të paditurën që në emër të kompensimit të pagës së trembëdhjeta për vitin 2022, t`ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 721.14 euro me kamat ligjore prej 8 % nga dita e arritjes së kërkesës e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura me datë 24.01.2024 ka paraqit përgjigje në padi, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa lejuar gjegjësisht të pas afatshme, mbështetur në nenin 78 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 79 i Ligjit Nr.03/L-212 të punës. Për sa u përket

2023:155901

kompensimit të pagës së trembëdhjetë e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ka shtuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 paragrafi 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë, çdo nismë, duke përfshirë edhe atë lidhur me nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare, nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të.
Ndërsa ka ardhur në konkluzione se sa i përket kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagës së 13-të, shujtave, për çdo vit kalendarik e kundërshtojmë pasi që kjo vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore, financiare dhe institucionale të të padituës dhe asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim, andaj e njëjta nuk mund të jetë obligim i të padituës. E paditura ndaj paditësit të vetmin detyrim ligjor e ka përmbushjen e kontratës së Punës e cila konsiderohet ligj për palët. Paditësi do të mund të kompensohet për pagën e 13-të, brenda mundësive institucionale ligjore dhe financiare, andaj deri më tani këto mundësi nuk janë krijuar, që nënkupton se nuk është detyrim për të padituën. Duke u bazuar në thëniet e lartcekura e paditura i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, të marr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të padituës, në kuptim të nenit 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e refuzoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi L.H. nga data 24.04.2000 është në marrëdhënie pune pranë të padituës. Gjykata përmes vërtetimit të punësimit me numër të referencës DDK-05/0627/2021 të datës 27.05.2021, vërtetoi faktin se paditësi për punën që e kryen pranë të padituës merr pagën prej 721.14 euro në muaj. Po ashtu përmes formularëve të vlerësimit të përformancës për vitin kalendarik 2022 gjykata vërtetoi faktin se paditësi për vitin 2022 ka pasur vlerësim të përgjithshëm, me notën 4, që korrespondon me vlerësimin plotësisht i kënaqshëm.

Vërtetimin si dhe formularët e lartcekur, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se "*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të",* ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj. Andaj vërtetimit me të cilin është konstatuar se paditësi është ne marrëdhënie pune pranë të padituës dhe formularëve me të cilin është bërë vlerësimi i punës së paditësit për vitet kalendarike 2022, Gjykata ia fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2021, i datës 29.09.2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës

2023:155901

Supreme të Kosovës, nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilare në policinë e Kosovës.

Në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ku përcaktohet se: *"I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit"*. Në nenin 44 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë përcaktohet se: "*Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor".* Ndërsa neni 55 par.1 nënpar.1.7 i këtij Ligji përcakton se: "*Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji".* Ndërkaq në nenin 30 paragrafi 2 të këtij udhëzuesi është paraparë se "*Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit" nëse ka mjete buxhetore.*

Pastaj, bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilare në policinë e Kosovës është paraparë se "*në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021*".

Andaj bazuar në mendimin juridik, është përcaktuar në mënyrë shprehimore se çështja e kompensimit të pagës së trembëdhjetë (13), për personelin e policisë është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, respektivisht nëse ka mjete buxhetore. Pra, e drejta e punëmarrësit (paditësit) për të realizuar pagën e trembëdhjetë (13) për vitin 2022, krijohet kur punëdhënësi (e paditura) nuk e përmbushë atë, ndërsa nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Në fund, është në barrën e punëdhënësit që të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e një kërkese të tillë.

Së këndejmi, në përgjigjen në padi, e paditura në mënyrë konkrete ka sqaruar se nuk kanë pasur mundësi buxhetore për të realizuar pagën e trembëdhjetë (13) për personelin e policisë. Andaj, gjykata vlerëson se dispozita ligjore e nenit 30 par. 2 të Udhëzimit Administrativ të datës 29.09.2021, nuk është e karakterit detyrues për palët kontraktuese. Kështu, duke u mbështetur edhe në mendimin juridik nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, duke qenë se të provuarit e faktit nëse ka mundësi buxhetore i ka takuar të padituës, e njëjta me përgjigjen në padi të datës 16.11.2023, ka provuar se nuk ka mundësi buxhetore për të kompensuar pagën e trembëdhjetë (13) ndaj paditësit.

Kësisoj, gjykata duke vlerësuar bazën ligjore të theksuar më lartë dhe gjendjen faktike të vërtetuar, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet refuzuar si e pabazuar. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia e paditësit, qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe në bazën juridike konkrete.

Gjykata ka vendosur si dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e shujtave ditore dhe atë për vitin 2022 pasi që paditësi nuk ka arritur që

të provojë se këtu me të padituren si punëdhënës ka raport kontraktual ku është përcaktuar detyrimi i të padituës për paditësin për kompensimin e shujtave ditore.

Pretendimi i paditësit, se në neni 29 par.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës përcakton detyrimin mbi ushqimin gjatë ditëve të punës gjykata e gjeti si të pa bazuar, pasi që në neni 29 par.1 të këtij udhëzimi parashihet që "*Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici"* pra kjo dispozitë përcakton kushtet të përgjithshme të cilave palët kontraktuese, duhet të ju përmbahen lidhur me të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga marrëdhënia e punës, ku kriter për vendosur mbi këto të drejta duhet të jetë vendi i punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici, por si dispozitë nuk përcakton në vetvete detyrimin për kompensim, e në këtë çështje kontestimore kompensimin për shujta ditore. Gjykata në kuptim të nenit 47 par 4 të ligjit për policinë (LIGJI Nr. 04/L-076) ku përcaktohet se *"Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore",* vlerëson se për të ju njohur e drejta për kompensim në shujta duhet të përcaktohet shprehimisht në Ligj apo në aktet e brendshme nënligjore (që në rastin konkret nuk është përcaktuar shprehimisht me aktet nënligjore të të padituës se personelit policor i takon e drejta e kompensimit në shujta ditore), si dhe bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilare në policinë e Kosovës është paraparë se *"në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e shujtës ditore për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, nuk aplikohet neni 29 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe neni 30 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021".*

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 par. 1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *"kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia"*. Ndërsa në paragrafin 2 të nenit të lartcekur është paraparë se *"kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura*".

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në nenin 450, 452 dhe 463 të LPK-së. Pra, përkundër faktit se pala paditëse i ka kërkuar shpenzimet procedurale, kërkesëpadia e saj ishte e pabazuar dhe kështu ka humbur kontestin në këtë procedurë gjyqësore. Në anën tjetër, përkundër faktit se e paditura ka fituar kontestin, e njëjta nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.2409/2023 datë 21.02.2024

Gjyqtarja

Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.